REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 shkurt 2013
Nr.ref.:AGJ361/13

AKTGJYKIM

në

Rastin KI41/12

Parashtrues

Gëzim dhe Makfire Kastrati

kundër

Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë prindërit e të ndjerës D. K., z. Gëzim Kastrati dhe znj. Makfire Kastrati, me vendbanim në Prishtinë, të përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh.p.k., me seli në Prishtinë.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka vepruar sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182. Rrjedhimisht, shkelja nuk është pasojë e një vendimi gjyqësor, por e mosveprimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Baza juridike

3. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); në nenin 21 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 17 prill 2012, parashtruesit dorëzuan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Kushtetuese), me pretendimin se Gjykata Komunale në Prishtinë, me mosveprimin e saj, ka bërë shkelje të nenit 25, të nenit 31, të nenit 32 dhe të nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

5. Më 23 prill 2012, Kryetari emëroi gjyqtaren Iliriana Islami, si gjyqtare raportuese, dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

6. Më 4 maj 2012, Gjykata Kushtetuese i dërgoi njoftim parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi informacione dhe dokumente shtesë.

7. Më 7 maj 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës përkitazi me kërkesën e parashtruar dhe i ftoi për t'i paraqitur komentet e tyre për pretendimet e ngritura.

8. Më 8 maj 2012 parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese një parashtresë për zgjerimin e kërkesës fillestare, duke kërkuar shqyrtimin e pohimeve për shkelje të së drejtës për jetë, të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës, me nenin 3 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

9. Më 11 maj 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi informacionet dhe dokumentet shtesë, të kërkuara nga Gjykata Kushtetuese, më 4 maj 2012.

10. Më 31 maj 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK) për zgjerimin e kërkesës fillestare nga parashtruesi i kërkesës dhe, në të njëjtën kohë, kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë t'i ofrojë komentet përkitazi me pretendimet e ngritura nga parashtruesi.

11. Në të njëjtën ditë, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë të dorëzojë dokumentacionin e kompletuar të lëndës së të ndjerës dhe kërkoi nga KGJK-ja të ofrojë informacione për hapat e ndërmarrë në adresimin e rastit të së ndjerës. Deri më tash, nuk është pranuar asnjë përgjigje nga Gjykata Komunale në Prishtinë.

12. Më 7 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese pranoi një përgjigje nga KGJK-ja, me të cilën u informua për hapat e ndërmarrë nga KGJK-ja përkitazi me rastin në fjalë.

13. Më 2 korrik 2012, Kryetari zëvendësoi gjyqtaren Iliriana Islami, si gjyqtare raportuese, për shkak të përfundimit të mandatit, me gjyqtarin Altay Suroy.

14. Më 25 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit paraprak të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Parashtruesit janë prindërit e D. K., e lindur më 18 shkurt 1984, në Prishtinë, e cila u privua nga jeta më 18 maj 2011. D. K. ka jetuar me familjen e saj deri më 10 shkurt 2000.

16. Gjatë vijimit të shkollës së mesme, D. K. ishte njoftuar me A. J., me të cilin krijoi marrëdhënie personale dhe, më 2 shkurt 2000, bashkë vendosin të themelojnë bashkësi jashtëmartesore.

17. Më 2 gusht 2003, D. K.-së dhe A. J.-së u lind një vajzë.

18. Më 17 janar 2011, D. K. paraqiti padi për shkëputjen e bashkësisë së saj jashtëmartesore me A. J.-në, shkaku i çrregullimit të marrëdhënieve ndërmjet tyre.

19. Pas paraqitjes së padisë, D. K. mori vajzën dhe, së bashku, shkuan të prindërit e saj për të jetuar.

20. Më 26 prill 2011, D. K., me një parashtresë drejtuar Gjykatës Komunale në Prishtinë, bëri precizimin e padisë së 17 janarit 2011, ashtu që, atëbotë, kërkoi që objekt i shqyrtimit të jetë vetëm çështja e besimit në ruajtje, ushqim dhe shkollim të vajzës së tyre.

21. Gjithashtu, më 26 prill 2011, si pasojë e kërcënimeve të vazhdueshme të pretenduara nga A. J. në drejtim të D. K.-së dhe në drejtim të vajzës së tyre, D. K. paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, bazuar në nenin 15 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L182.

22. Më 18 maj 2011, D. K. vdiq pasi mori plagë në qafë, nga armë zjarri, e shkrepur nga A. J. Ndërsa, vajza A. u dërgua te prindërit e A. J.-së, në vendbanimin e tyre në hotelin "AS".

23. Më 30 maj 2011, prindërit e D. K.-së (parashtruesit) paraqitën parashtresë për precizimin e padisë së parashtruar në Gjykatën Komunale në Prishtinë nga D. K.-ja, më 17 janar 2011, në të cilën kërkohet që i padituri të jetë S. J. (babai i A. J.-së).

24. Më 29 korrik 2011, organizata joqeveritare CLARD (Centre for Legal Aid and Regional Development), sipas autorizimit të parashtruesve, i dorëzoi Këshillit Gjyqësor të Kosovës Shkresën 01/031-1031, "kërkesë për efikasitet në zbatimin e Ligjit Kundër Dhunës në Familje", duke u përqendruar në rastin e D. K.-së.

25. Më 29 shtator 2011, organizata joqeveritare CLARD, duke insistuar, dërgoi edhe një herë Shkresën 01/031-1031, nëpërmjet të cilës kërkoi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës njoftim apo përgjigje në kërkesën e dërguar paraprakisht.

26. Më 07 nëntor 2011, organizata joqeveritare CLARD pranoi përgjigje nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për Shkresën 01/031-1031, në të cilën thuhet se kërkesa do të trajtohet në njërën nga mbledhjet e radhës të Këshillit. Gjithashtu, shkresa sugjeron se, për raste të caktuara, ku CLARD-i konsideron që gjyqtarët e caktuar kanë dështuar të zbatojnë ligjin, të iniciojë hetime në Zyrën e Prokurorit Disiplinor (Ligji mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Kreu VII; neni 43, neni 44 dhe neni 45).

Pohimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Komunale e Prishtinës, me mosveprimin e saj në përputhje me obligimet e saj kushtetuese dhe ligjore për ta trajtuar kërkesën për urdhër për mbrojtje emergjente, ka cenuar të drejtat individuale të D. K.-së dhe, tërthorazi, të parashtruesve të kërkesës, të garantuara me nenin 25, me nenin 31, me nenin 32 dhe me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me nenin 2, me nenin 6 e me nenin 13 të KEDNJ-së.

28. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se Gjykata Kushtetuese duhet ta adresojë këtë çështje, me qëllim të parandalimit të rasteve të njëjta tragjike në të ardhmen, si dhe me qëllim të vetëdijesimit të opinionit publik për urgjencën e funksionalizimit të gjykatave të rregullta.

29. Më tej, parashtruesit theksojnë se "Gjykata Komunale e Prishtinës ka pasur obligim të veprojë brenda njëzetekatër (24) orësh nga momenti kur D. K. ka paraqitur kërkesë për urdhër për mbrojtje emergjente. Ajo gjykatë nuk ka

vepruar fare në këtë rast. Shqyrtimi i legjislacionit përkatës tregon se sa i përket mjeteve juridike në rastet e veprimit nga Gjykata Komunale e Prishtinës, kur ajo duhet të veprojë siç i obligon neni 19 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182, mund të konstatohet se nuk ekzistojnë mjete juridike, të cilat mund të përdorë viktima në rastin e mosveprimit të Gjykatës Komunale".

30. Parashtruesit, gjithashtu, theksojnë se "neni 19 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182, parasheh vetëm procedurat ankimore kundër vendimeve gjyqësore për urdhër për mbrojtje, mirëpo nuk parasheh mjete juridike për paraqitësit e kërkesave për mbrojtje në rastet kur gjykata nuk vepron fare".

31. Për më tepër, sipas parashtruesve, "po ashtu, Ligji për Procedurën Kontestimore, Nr. 03/L-006, parasheh një mori mjetesh juridike – duke përfshirë ankesën, revizionin, përsëritjen e procedurës dhe mbrojtjen e ligjshmërisë – mirëpo, të gjitha këto mjete juridike, nuk adresojnë rastin kur shkeljet e pretenduara kushtetuese janë pasojë e mosveprimit të autoritetit publik (mosekzistimit të vendimit gjyqësor). Njësoj, edhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/L-223, në nenet 33-49, parasheh vetëm inicimin e procedurës disiplinore dhe sanksionet kundër gjyqtarëve ose gjyqtarëve porotë për sjellje të pahijshme. Mirëpo, ky ligj nuk parasheh mjete juridike për rrethanat aktuale, kur Gjykata nuk vepron në mbrojtjen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare".

32. Parashtruesit insistojnë që, "në këtë rast, jo vetëm që shterja e mjeteve juridike nuk është efektive, por është e pamundshme, pasi që, në fakt, mjetet juridike nuk ekzistojnë fare".

33. Më tej, parashtruesit pohojnë se, nëpërmjet OJQ-së CLARD, i janë drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, me qëllim të parandalimit të neglizhencës nga gjykatat e rregullta, që për pasojë kanë shkeljen e të drejtave individuale të viktimave të tjera. Mirëpo, sipas parashtruesve, ky adresim nuk ka qenë i frytshëm, pasi KGJK-ja fillimisht nuk i është përgjigjur shkresave të dërguara nëpërmjet CLARD-it, e më vonë ka dhënë përgjigje se çështja do të adresohet në mbledhjen e radhës së KGJK-së, mirëpo parashtruesit nuk kanë pranuar asnjë përgjigje për këtë deri më 26 mars 2012.

34. Parashtruesit theksojnë se, më 26 mars 2012, nëpërmjet OJQ-së CLARD, kanë pranuar një shkresë nga KGJK-ja, me të cilën informohen se KGJK-ja u ka dërguar gjykatave komunale vendimin e tij që i udhëzon ato gjykata të zbatojnë Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182. Me këtë, sipas parashtruesve, "KGJK jo vetëm që nuk adreson rastin e D. K.-së dhe shkeljen e të drejtave të saj, mirëpo nuk ofron mjete juridike për rastet e ardhshme të dhunës në familje, kur viktimat kërkojnë veprime nga gjykatat komunale, por ato nuk veprojnë fare".

35. Për më tepër, parashtruesit pretendojnë se "vetë mungesa e mjeteve juridike, teorike dhe praktike, në këtë rast, mund të cilësohet si shkelje e të drejtave individuale. Neni 13 i KEDNJ-së dhe neni 32 i Kushtetutës garantojnë të drejtën për mjete juridike. Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L182, nuk

parasheh fare mjete juridike për paraqitësit e kërkesave për urdhër për mbrojtje nga dhuna në rastet kur gjykata nuk vepron fare. Prandaj, pamundësia e qasjes në mjete juridike në rastin e paracekur, në vetvete nënkupton shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa".

36. Në shtjellimin e pretendimit të tyre për shkelje të nenit 25 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të KEDNJ-së, parashtruesit i referohen praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) duke theksuar se "kjo gjykatë, në rastin *Osman v. The United Kingdom,* ka vlerësuar se personi që pretendon se i është cenuar e drejta në jetë duhet të dëshmojë se (1) autoriteti e ka ditur ose është dashur ta dijë në atë kohë për ekzistimin e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një personi ose personave të identifikuar nga veprat kriminale të një pale të tretë dhe (2) ka dështuar të ndërmarrë masat brenda fushëveprimit të fuqive të tij që, të gjykuara arsyeshëm, mund të jenë pritur ta kenë parandaluar atë rrezik. Pra, shteti ka obligim të veprojë kur kushtet e paracekura dëshmohen nga personi, në të kundërtën cilësohet se ia ka cenuar personit të drejtën në jetë".

37. Për më tepër, parashtruesit pohojnë se "GJEDNJ-ja shkon edhe një hap më tutje dhe gjykon se një person, që të mbajë shtetin përgjegjës për shkelje të së drejtës për jetë, duhet vetëm të dëshmojë se autoriteti nuk ka bërë të tërën që mund të pritet nga ai brenda arsyes që të parandalojë një rrezik real dhe të menjëhershëm ndaj jetës për të cilin kanë ose duhet të kenë pasur njohuri".

38. Më tej, parashtruesit theksojnë se "ekziston një mori rastesh ku GJENDJ-ja ka gjykuar se autoriteti publik ka cenuar të drejtën për jetë në rrethana kur ka dështuar të veprojë në mbrojtje të personit, pra në rrethana shumë të përafërta me ato të D. K.-së. Në rastin *Kontrova v. Slovakia,* policia kishte bindur një grua që të tërheqë denoncimin penal ndaj bashkëshortit kur ai e kishte rrahur me kabllo elektrike. Pas tërheqjes së denoncimit penal, bashkëshorti kishte vrarë djalin e vajzën dhe gruas nuk iu dha kompensim. GJEDNJ-ja gjykoi dhe gjeti shkelje të së drejtës për jetë, specifikisht të nenit 2 të Konventës Evropiane, për arsye se policia kishte dështuar të mbrojë jetët e fëmijëve. Njëherazi, gjykata gjeti edhe cenim të nenit 13 (E Drejta për Mjete Efektive), për shkak të moskompensimit të nënës. Qëndrime të ngjashme për cenim të së drejtës për jetë (neni 2), GJEDNJ-ja ka treguar edhe në raste të tjera, si: *Branko Tomašić and Others v. Croatia* dhe *Opuz v. Turkey*".

Përgjigja nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës

39. Në përgjigjen e KGJK-së, të pranuar më 7 qershor 2012, ndër të tjera theksohet:

"Komisioni Disiplinor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës e ka pranuar më 21 korrik 2011 propozimin ZPD/11/kb/0556 për inicimin e procedurës për suspendimin e gjyqtarit E. Sh., gjyqtar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për sjellje të pahijshme: Dështim për të kryer funksionin e gjyqësorit nga neni 34 par. I pika 1.2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës: b) Shkelje e Kodit Relevant të Etikës neni 34 par. I pika 1.4 të Ligjit dhe atë: I. Parimet e përgjithshme pika I (gjyqtari vepron në çdo kohë në atë mënyrë që të nxit besimin e publikut në dinjitet, integritet dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor);

b) Respekton dhe i përmbahet ligjit; c) kryen detyra në mënyrë të kujdesshme; e) kryen detyra konform me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; dhe II Rregulla specifike A. Veprimtaritë Gjykuese, I. Gjatë procedurës Gjyqtari ka për detyrë t'i mbrojë të drejtat dhe liritë e gjithë personave. Komisioni Disiplinor i KGJK-së ka mbajtur seancë për shqyrtimin e kësaj kërkese për suspendim me datë 31.08.2011 dhe ka refuzuar kërkesën për suspendim me pagesë si të pabazë dhe si e tillë është refuzuar për arsye se prej kohës kur është dorëzuar propozimi ka kaluar një kohë e gjatë nga dita kur ka ndodhur rasti tragjik, respektivisht propozimi është dorëzuar me datë 21 korrik 2011, pra kanë kaluar afër dy muaj dhe shqiptimi i kësaj mase nuk do të kishte kurrfarë efekti.

Në bazë të nenit 36 par. I të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Komisioni Disiplinor mori vendim që ndaj E. Sh., gjyqtar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, të iniciohet procedura dhe hetim disiplinor dhe kjo seancë të mbahet në afatin ligjor kur Zyra e Prokurorit Disiplinor të dërgojë raportin përfundimtar.

Kundër këtij vendimi është bërë ankesë nga ZPD-ja, dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka mbajtur mbledhje dhe e ka shqyrtuar këtë ankesë me datë 31 tetor 2011, ankesën e Zyrës së Prokurorit Disiplinor e ka hedhur poshtë si jolëndore, pasi që komisioni ka mbajtur seancë dhe ka marrë vendim lidhur me këtë çështje. Komisioni Disiplinor në seancën e mbajtur me datë 18.10.2011 me vendimin me numër KD. nr. 40/2011, i ka shqiptuar masën disiplinore Ulje e rrogës për 50% për dy muaj nga paga mujore. Me këtë vendim me numër KD. nr. 40/20 II ka përfunduar procedura kështu që pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, për të cilën do të vendos Këshilli, mirëpo kundër këtij vendimi nuk ka bërë ankesë asnjëra palë".

Ligji i zbatueshëm

40. Dispozitat ligjore relevante përkitazi me shkeljet e pretenduara të parashtruesit janë të definuara në instrumentet e mëposhtme:

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182:

Neni 1 [Qëllimi i ligjit]

1. *Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.*
2. *Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.*

[...]

Neni 13 [Kërkesat për urdhërmbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente]

1. *Kërkesën për urdhërmbrojtje mund ta paraqesë:*
   - *1.1. pala e mbrojtur;*
   - *1.2. përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;*
   - *1.3. mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;*
   - *1.4. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri.*

2. *Kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente mund ta paraqesë:*
   - *2.1. pala e mbrojtur;*
   - *2.2. përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;*
   - *2.3. mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;*
   - *2.4. personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare;*
   - *2.5. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur e ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri;*
   - *2.6. personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një apo më tepër vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur.*

3. *Kërkesë për urdhërmbrojte ose për urdhërmbrojtje emergjente mund të paraqesin edhe OJQ-të, që janë familjarizuar me problemin e viktimës, që janë njoftuar mirë për trajtimin e tyre.*

[...]

Neni 16 [Shqyrtimi i kërkesës për urdhërmbrojtje emergjente]

1. *Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente brenda njëzetekatër (24) orësh pas parashtrimit të kërkesës.*
2. *Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhërmbrojtje emergjente, gjykata duhet të mbajë seancë në të cilën dëgjohen personat në vijim:*
   - *2.1. pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimave;*
   - *2.2. kryerësi i dhunës ose përfaqësuesi i autorizuar;*
   - *2.3. parashtruesi i kërkesës; dhe*
   - *2.4. çdo dëshmitar, i cili ka njohuri për dhunën në familje.*
3. *Sipas nevojës, gjykata mund të bëjë dëgjimin dhe shqiptimin e urdhrit mbrojtës në mungesë të kryerësit të dhunës ne familje, duke shfrytëzuar dhe mjetet tjera alternative përfshirë ato elektronike.*

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/L-223:

Neni 34 [Sjellja e pahijshme]

1. *Për qëllimet ë këtij ligji, sjellje të pahijshme nga gjyqtari apo gjyqtari porotë përbën:*

1.1. dënimi përfundimtar për një vepër penale, përpos kundërvajtjeve siç përkufizohet me ligj;
1.2. neglizhencë në kryerjen , dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore;
1.3. të dështuarit e kryerjes së funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme;
1.4. shkelja e kodeve të zbatueshme të etikës

2. *Komisioni Disiplinor mund të pezullojë gjyqtarin apo gjyqtarin porotë me pagesë gjatë cilësdo fazë të hetimit apo gjatë procedurës disiplinore.*
3. *Këshilli Gjyqësor nxjerr rregullore që përcakton sjelljet e pahijshme.*

[...]

Neni 37 [Masat disiplinore]

1. *Komisioni Disiplinor mund të vendosë sanksionet disiplinore si në vijim:*
   1.1. qortim;
   1.2. qortim me udhëzim për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese;
   1.3. ulje të përkohshme të rrogës deri në pesëdhjetë për qind (50%) duke pasur parasysh natyrën e sjelljes së pahijshme; ose
   1.4. propozim për largimin nga zyra e gjyqtarit apo gjyqtarit porotë.

2. *Komisioni vendos një sanksion i cili është në përputhje me rrethanat, nivelin e përgjegjësisë dhe pasojat e sjelljes së pahijshme;*
3. *Komisioni, siç ceket në këtë ligj, i dërgon Këshillit një rekomandim në formë të shkruar për shkarkimin nga detyra të një gjyqtari;*
4. *Nëse gjyqtari apo gjyqtari porotë pas përfundimit të procedurës disiplinore lirohet nga akuzat, ai apo ajo, me vendim të Këshillit, kthehet në zyrën e tij apo saj të mëparshme.*

Neni 38 [Shkarkimi i Gjyqtarëve dhe Gjyqtarëve Porotë]

1. *Bazuar në procedurat disiplinore, Këshilli vendos nëse sjellja e pahijshme e gjyqtarit apo gjyqtarit porotë justifikon shkarkimin. Çdo rekomandim i Këshillit për shkarkimin e një gjyqtari apo gjyqtari porotë përfshin arsyet me shkrim për rekomandimet e tilla si dhe konkluzionet themelore të Komisionit.*
2. *Rekomandimi i Këshillit për shkarkim si parashihet në paragrafin 1. të këtij neni, i dërgohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh Presidentit dhe gjyqtarit apo gjyqtarit porotë në fjalë.*
3. *Presidenti i Republikës së Kosovës vendos për rekomandimin e Këshillit për shkarkim në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me këtë ligj.*
4. *Lidhur me vendimin e Presidentit të Kosovës mbi miratimin apo refuzimin për shkarkim, gjyqtarët apo gjyqtarët porotë njoftohen zyrtarisht nga Këshilli para se një vendim i tillë të zbatohet.*

[...]

Neni 45 [Përgjegjësitë e Prokurorit Disiplinor]

1. *Zyra e Prokurorit Disiplinor është përgjegjëse për inicimin e hetimit ndaj gjyqtarëve apo gjyqtarëve porotë aty ku ekziston bazë e arsyeshme për të besuar që sjellja e pahijshme mund të ketë ndodhur si dhe për ofrimin e rekomandimeve dhe paraqitjes pranë Komisionit Disiplinor të provave në mbështetje të veprimit disiplinor.*
2. *Zyra e Prokurorit Disiplinor inicion hetime në rastet kur:*
   - *2.1. pranë Zyrës së Prokurorit Disiplinor ekziston ankesa e paraqitur nga cilido person fizik apo juridik;*
   - *2.2. Me vetiniciativë, kur ekziston bazë e arsyeshme për të besuar se një gjyqtar apo gjyqtar porotë mund të jetë përfshirë një sjellje e pahijshme.*
3. *Të gjitha ankesat, pavarësisht origjinës së tyre, dërgohen për hetim në Zyrën e Prokurorit Disiplinor.*
4. *Zyra e Prokurorit Disiplinor heton hollësisht të gjitha çështjet që i referohen, vendos nëse rekomandimet për veprime disiplinore duhet t'i paraqiten Komisionit Disiplinor si dhe njofton me shkrim Komisionin Disiplinor dhe gjyqtarët apo gjyqtarët porotë të dyshuar lidhur me rezultatet e hetimit.*
5. *Zyra e Prokurorit Disiplinor ka të drejtë të thërrasë dëshmitarë si dhe dokumentet e nevojshme për hetim dhe të përcaktojë nëse rekomandimet për veprim disiplinor duhet të paraqiten tek Komisioni Disiplinor.*
6. *Zyra e Prokurorit Disiplinor i paraqet Komisionit Disiplinor rekomandimet për veprimet disiplinore si dhe provat në mbështetje të veprimit disiplinor për sjellje të pahijshme.*

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

41. Për të qenë në gjendje të vlerësojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parashikon si në vijim:

    "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj";

    si dhe nenit 47 të Ligjit, i cili përcakton:

    "Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik";

    dhe se:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi ti ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

43. Gjykata, së pari, shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i përmbushin kushtet e parapara për të qenë palë e autorizuar në përputhje me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore.

44. Për këtë qëllim, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila, në raste të ngjashme, ka pranuar kërkesa individuale nga individët që konsiderohen si viktima të tërthorta, kur ekziston një lidhje personale dhe specifike ndërmjet viktimës dhe parashtruesit. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja, në një rast, ka pranuar si palë të autorizuar bashkëshorten e të ndjerit (*Shih, McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 18984/91, Aktgjykimi i 27 shtatorit 1995),* ndërsa, në një rast tjetër, nipit të të ndjerit i ka pranuar statusin e palës së autorizuar *(Shih, Yaşa kundër Turqisë, nr. 63/1997/847/1054 , Aktgjykim i 2 shtatorit 1998).*

45. Si rrjedhojë, duke marrë parasysh se parashtruesit e kërkesës janë prindërit e të ndjerës, Gjykata konstaton se parashtruesit mund të konsiderohen palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47 të Ligjit.

46. Përveç kësaj, Gjykata duhet të konstatojë nëse parashtruesit i kanë shteruar mjetet ekzistuese juridike në kuadër të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

47. Gjykata Kushtetuese rikujton se, në Aktgjykimin AGJ63/10 në Rastin KI06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, theksoi që, sipas praktikës së mirëfilltë gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës duhet të shterojnë mjetet juridike vendëse, që janë në dispozicion dhe që janë efektive. Për më tepër, ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar. GJEDNJ-ja, më tej, pranoi që rregulli i shterjes së mjeteve juridike nuk është as absolut e as në gjendje të zbatohet në mënyrë automatike. Me rastin e shqyrtimit, nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të merren parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se ai duhet të ketë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve zyrtare juridike në sistemin e vendit në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës (*Shih aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Akdivar kundër Turqisë*).

48. Gjykata Kushtetuese vëren se, më 26 prill 2010, e ndjera D. K. ka dorëzuar kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente.

49. E ndjera nuk ka pasur ndonjë mjet tjetër juridik, pasi ajo nuk ka pranuar asnjë vendim nga Gjykata Komunale në Prishtinë, që do të pranonte apo që do të refuzonte kërkesën e saj.

50. Në anën tjetër, parashtruesit e kërkesës insistojnë se as ata nuk kanë pasur mjete në dispozicion dhe efektive që do të mund t'i ushtronin.

51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe nga përgjigja me shkrim e KGJK-së, ku përshkruhet procedura disiplinore e zhvilluar për këtë rast, e tëra që kanë mundur të bëjnë parashtruesit, është ankesa drejtuar Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ndërsa në fazat e mëtutjeshme në komisionin përkatës në KGJK, dhe se ata nuk kanë pasur mundësi të jetë palë në procedurë.

52. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk kanë pasur ndonjë mjet juridik efektiv në dispozicion, për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.

53. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë, pasi parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, pasi ata nuk kanë pasur mjete juridike në dispozicion që do të ishin efektive dhe pasi ata i kanë qartësuar saktësisht shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë të kërkesës

I. Sa i përket të drejtës për jetë

54. Parashtruesit ankohen se, si pasojë e mosveprimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, ka ndodhur shkelja e të drejtës për jetë, e paraparë më nenin 25.1 të Kushtetutës.

55. Neni 25.1 i Kushtetutës thekson:

"Secili individ gëzon të drejtën për jetën".

56. Në anën tjetër, neni 2 i KEDNJ-së, thekson:

"E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj".

57. Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta për jetën është e drejta më e rëndësishme e të gjitha qenieve njerëzore. Është e drejtë nga e cila rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera.

58. Gjykata Kushtetuese rikujton se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, është detyrim i saj kushtetues që interpretimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut ta bëjë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

59. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja thekson se është detyrim i organeve shtetërore që, jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por gjithashtu të ndërmarrin hapat e duhur për mbrojtjen e jetës së individëve brenda juridiksionit të tyre (*Shih, L. C. B. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 9 qershor 1998*). Kjo nënkupton detyrimin parësor të shtetit që të sigurojë të drejtën për jetë, duke vendosur dispozita penale efektive për të penguar kryerjen e veprave penale kundër individit, të mbështetura nga mekanizmat e zbatimit të

ligjit për parandalimin, për ndëshkimin dhe për shuarjen e shkeljeve të dispozitave të tilla. Në rrethana të përshtatshme, zgjerohet gjithashtu një detyrim pozitiv për autoritetet që të marrin masa parandaluese operative për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga veprat penale të një individi tjetër (*Shih, Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 tetor 1998, i cituar edhe në Kontrova kundër Sllovakisë, 24 shtator 2007, dhe Opuz kundër Turqisë, 9 qershor 2009*).

60. Për më tepër, për t'u ngritur një detyrim pozitiv, duhet të vërtetohet nëse autoritetet kanë ditur apo është dashur të dinë, në kohën e ekzistimit të një rreziku real dhe të menjëhershëm, për jetën e një individi të identifikuar nga veprat kriminale të një pale të tretë dhe që kanë dështuar të ndërmarrin masa brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre që, gjykuar arsyeshëm, do të mund të pritej ta mënjanonin atë rrezik (*Ibid., paragrafi 116*).

61. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se, nga dokumentacioni i deponuar në Gjykatë, mund të konstatohet që autoriteti përgjegjës, në këtë rast Gjykata Komunale në Prishtinë, është dashur të dijë për rrezikun real që ka ekzistuar me rastin e dorëzimit të kërkesës për lëshim të urdhrit për mbrojtje emergjente, pasi D. K.-ja ka shpjeguar në mënyrë kronologjike përkeqësimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre, duke specifikuar edhe kërcënimet me vdekje nga ish-partneri dhe duke ofruar dëshmi për raportimin paraprak në organet policore për kërcënimet e pranuara.

62. Për më tepër, Gjykata Komunale në Prishtinë paraprakisht ka trajtuar një lëndë të iniciuar nga D. K.-ja për shkëputjen e bashkësisë jashtëmartesore dhe për caktimin e kujdestarisë së fëmijës së të ndjerës dhe ish-partnerit të saj, kur edhe kishte filluar shfaqja e problemeve serioze ndërmjet tyre dhe që, më vonë, kishte rezultuar me kërcënime të ndryshme.

63. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se Gjykata Komunale në Prishtinë ishte përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të parashikuara me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhe se mosveprimi i saj paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutës dhe nga neni 2 i KEDNJ-së.

II. Sa i përket të drejtës për mjete efektive juridike

64. Parashtruesit, gjithashtu, ankohen se është shkelur e drejta e tyre për mjete efektive juridike, e garantuar me nenin 32 dhe me nenin 54 të Kushtetutës.

65. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] thekson:

"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj".

66. Gjithashtu, neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] thekson:

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

67. Për më tepër, neni 13 i KEDNJ-së thekson:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".

68. Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin e 30 tetorit 2010, në rastin KI06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, ka trajtuar çështjen e mjeteve juridike efektive, me ç'rast ka theksuar: *"... që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë (në nivel kombëtar) të një mjeti juridik për ta zbatuar substancën e të drejtave dhe lirive të parapara me Konventë, në çfarëdo forme që mund të ndodhin për të qenë i siguruar në rendin ligjor të vendit. Qëllimi i nenit 13 është të kërkojë sigurimin e një mjeti juridik vendor për ta trajtuar substancën e një 'pretendimi të diskutueshëm' sipas Konventës dhe për të ofruar mbrojtje përkatëse juridike". (Shih Aktgjykimin 63 10, të 30 tetorit 2010, §91).*

69. Më tej, në po të njëjtin aktgjykim, Gjykata theksoi: *"Përmasa e obligimit sipas nenit 13 të Konventës ndryshon varësisht nga natyra e ankesës së parashtruesit të kërkesës; megjithatë, mbrojtja përkatëse juridike që kërkohet me nenin 13 duhet të jetë 'efektive' në praktikë dhe në ligj. 'Efektiviteti' i një 'mjeti juridik' brenda kuptimit të nenit 13 nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për parashtruesin e kërkesës. As 'autoriteti' i përmendur në atë dispozitë nuk është medoemos e thënë të jetë autoritet gjyqësor, por nëse nuk është, kompetencat e tij dhe garancitë që i ofron janë përkatëse për të përcaktuar nëse mjeti juridik para tij është efektiv. Gjithashtu, edhe nëse një mjet i vetëm juridik nuk i kënaq në tërësi kriteret e nenit 13, tërësia e mjeteve juridike të parapara me ligjin e vendit mund ta bëjë një gjë të tillë (Shih Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Silver dhe të tjerët kundër aktgjykimit të Mbretërisë së Bashkuar, i 25 marsit 1983, Seria A, nr. 61, p. 42, para. 113)". (Ibid., §92).*

70. Gjithashtu, duhet theksuar se i njëjti aktgjykim shpjegon se *"Rregulli i shterimit të mjeteve juridike bazohet në supozimin e pasqyruar në nenin 13 (me të cilin ka lidhje të ngushtë) se ekziston një mjet efektiv juridik në dispozicion për sa i përket shkeljes së supozuar të të drejtave të individit të parapara me Konventë (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Kudla kundër Polonisë, 26 tetor 2000).*

71. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se legjislacioni në fuqi: Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk ofrojnë mjete efektive juridike për mbrojtjen e të drejtave të parashtruesve.

72. Në fakt, në njërën anë, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje nuk parasheh masa për adresimin e mosveprimit të institucioneve përgjegjëse në ato raste kur janë të detyruara të veprojnë. Në anën tjetër, siç mund të shihet nga Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e po ashtu edhe nga përgjigja e KGJK-së, parashtruesit nuk kanë mundësi tjetër përveç ankesës drejtuar Zyrës së Prokurorit Disiplinor, por jo edhe më tutje në faza të tjera të procedurës. Sipas nenit 45.5 të këtij ligji, është e drejtë, por jo edhe detyrim i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, *"të thërrasë dëshmitarë si dhe dokumentet e nevojshme për hetim dhe të përcaktojë nëse rekomandimet për veprim disiplinor duhet të paraqiten tek Komisioni Disiplinor"*.

73. Gjykata rikujton se institucioni përgjegjës kryesor, Gjykata Komunale në Prishtinë, ka dështuar të ofrojë përgjigje në pyetjet e ngritura nga Gjykata dhe nuk ka ofruar dokumentacionin që posedon për këtë rast.

74. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konkludon se mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, në kërkesën e të ndjerës D. K. për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, si dhe praktika e zhvilluar nga KGJK-ja për adresimin e mosveprimit të gjykatave të rregullta atëherë kur duhet të veprojnë, ka penguar viktimën dhe parashtruesit e kërkesës në realizimin e të drejtave të tyre për mjete efektive juridike, të parapara me nenin 32 e me nenin 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së.

III. Sa i përket nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

75. Gjykata nuk e konsideron të nevojshme trajtimin e pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës, duke pasur parasysh që Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 25, të nenit 32 dhe të nenit 54 të Kushtetutës; të nenit 2 e të nenit 13 të KEDNJ-së; dhe për faktin se nuk është zhvilluar ndonjë dëgjim apo seancë gjyqësore për rastin në fjalë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, në bazë të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në bazë të rregullit 56.1 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 janar 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. Të shpallë kërkesën të pranueshme;

II. Të gjejë se ka pasur shkelje të së drejtës për jetë, të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës dhe me nenin 2 të KEDNJ-së;

III. Të gjejë se ka pasur shkelje të së drejtës për mjete juridike, të paraparë me nenin 32 e me nenin 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së;

IV. Të konsiderojë të panevojshëm trajtimin e pretendimit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të paraparë me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së;

V. T'ua komunikojë palëve këtë vendim;

VI. Të publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani